



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 01.03.2016**

**MARS
2016**

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

KRYESUESI BESIM BEQAJ: Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës në dëgjimin publik për Ligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

Dua të bëjë një sqarim, me qenë se kryetari i Komisionit do të vonohet, më ka autorizuar që ta filloj takimin derisa të vjen dhe pastaj do të na bashkëngjitet besoj për një kohë të caktuar për ta diskutua Ligjin për investimet strategjike.

Siç e dini Qeveria e Kosovës ka marrë një hap për të sjellur në Parlament Ligjin për investime strategjike.

Ligj i cili synon që të rregullon raportet e shtetit me investitorët potencial strategjik. Një ligj i cili është i nevojshëm por një ligj i cili në leximin e parë respektivisht në punën që ne si Komision kemi bërë, kemi diskutuar gjatë rreth tij dhe ishte një pajtim i plotë që të kemi një dëgjim publik për të dëgjuar dhe për të marrë opinionet edhe të juaja jo vetëm të sponzoruesit si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë dhe si Komision përgjegjës për trajtimin e këtij ligji por edhe për të marrë parasysh të gjitha vërejtjet, sugjerimet, komentet të cilat janë bërë.

Do të ju njoftoj më parë që ne kemi një analizë paraprake nga ana e GAP-it sa i përket ligjit dhe ka bërë një krahasueshmëri me ligjet ekzistuese në rajon. Pra, ka marrë parasysh Hungarinë, Kroacinë, Shqipërinë dhe Kosovën dhe ka bërë ... pra krahasimet e ngjashmërive respektivisht dallimet të cilat i kanë këto ligje.

Dhe, në ndërkohë kemi marrë edhe një shkresë nga ana e Komisionit Evropian i cili ka disa shqetësime sa i përket harmonizimit me ligjshmërinë apo rregullat e AKI-së të Bashkimit Evropian, sigurisht që këtë çështje do ta diskutojmë në vijim. Ajo çka është me rëndësi te ky ligj, është se tenton të identifikon fushat në potencial të investimeve strategjike.

Pra, në pjesën e parë të ligjit definohen se cilat janë fushat strategjike me interes për shtetin, pastaj vazhdon me kriteret të cilat duhet të plotësohen nga ana e ndërmarrjeve të cilat dëshirojnë ta marrin statusin e investitorit strategjik sipas kategorizimeve. Normalisht është e paraparë që përmes Agjencionit për Promovim të Investimeve të jetë hapi i parë përmes një komiteti dhe pastaj në Qeveri të merren vendime për dhënien e statusit për investitor strategjik.

Kemi diskutuar edhe lidhur me garancitë të cilat duhet t'i ofrojmë investitorët potencial strategjik në këtë ligji, garancitë financiare që kanë potencial financiar me realizua investimin, garanci të

cilat janë argument që ata do të vazhdojnë me investim por njëkohësisht edhe çfarëdo lloj shkelje e atyre procedurave të investimet janë të rregulluara në mënyrë goxha të mirë.

Janë definua edhe nivelet e investimeve në ligj, pra sa duhet për secilin sektor dhe sa vende të punës duhet të krijohen.

Është përcaktuar edhe roli i Qeverisë e cila në momente të caktuara edhe mund të jep subjektit edhe qasje të drejtpërdrejtë statusin e investitorit strategjik. Pra, janë disa çështje të cilat ne besojmë që t'i drejtojmë bashkërisht.

Ne në Komision kemi diskutua rreth kriterëve sepse besojmë që janë të pa definuar saktësisht cilat janë kriteret për dhënien e statusit për investitor strategjik, respektivisht kemi diskutuar rreth asaj se cilët sektor duhet të trajtohen si sektor strategjik, këtu janë diku rreth 14 sektor të përcaktuar me ligj po që besoj që mund të akumulohen sepse kemi disa sektor të cilët janë të përsëritur.

Kemi edhe çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë e them edhe me garanci, dhe kriteret respektivisht rolin dhe kategorizimin e investimeve potenciale në këtë proces dhe procedurat të cilat duhen të respektohen deri në realizimin dhe pas realizimit të statusit për investime strategjike.

Siç e thash, krahasimet janë bërë. Pra, edhe grupi për studime politike dhe sociale dhe GAP-i ... thotë e kanë afdua një dokument të kondensuar i cili është dokument realisht i mirë, ka dallime në mes të ligjeve të cilat bëjnë. Për shembull Kroacia ka një qasje tjetër të kontrollit të investimeve, pastaj Shqipëria ka të definuar pak më mirë, investitori strategjik i cili i mbulon, ka status special të investitori strategjik.

Pra, janë disa gjëra të cilat besoj që ne mund ti trajtojmë.

Unë këtu dua të ndalem dhe të hapi diskutimin pra për të gjitha sugjerimet, qëllimi është që ta bëjmë një ligj të mirë, një ligj i cili do ta ndihmonë ekonominë, thash që nga ana e Komisionit Evropian vërejtja është kryesore për çështjet e prokurimit, a është kjo një farë monopoli apo është një rrugë më e shkurtër për ta eliminua burokracinë, kjo është ideja e ligjit se të eliminohet burokracia dhe për investime strategjike të hyjmë në negociata të drejtpërdrejta.

Kështu që ne jemi sot këtu për të marrë mendimet e juaja secilit veç e veç lidhur me këtë ligj.

Unë këtu do të ndalem dhe do të hapi diskutimin për të pranishmit. Ju lutem që para se të merrni fjalën të prezantoheni për shkak të procesverbalit të cilin duhet ta mbajmë.

Urdhëroni! Ndoshta ministria, Rexhepi të na bënë një shpjegim lidhur me ligjin pak më detal. Faleminderit!

REXHEP BLLACA: Faleminderit, deputetë!

Faleminderit, të pranishëm!

Unë jam Rexhep Bllaca, drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si hartues edhe propozues i këtij projektligji për investime strategjike shkurtimisht të paraqes arsyen, rëndësinë dhe pse është proceduar projektligji për investime strategjike, ndërsa në fund do të hapet debati gjithmonë në funksion që të kemi një ligj sa më cilësorë dhe më funksional dhe të zbatueshëm në praktikë.

Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të vazhdon me procedimin e pakos legislative e cila e përmirëson ambientin biznesor për investimet vendore dhe të huaja në Republikën e Kosovës. Gjatë përvojës tonë si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë ku e kemi edhe Agjencionin për Investime të Huaja në ministrinë tonë, kemi hasur se institucionet e Republikës së Kosovës kanë shumë vështirësi sa i përket tërheqjes dhe nxitëse investimeve të huaja. Këto vështirësi zakonisht janë si rezultat i procedurave dhe rregullave të gjata burokratike dhe si pasojë e procedurave të komplikuar me rastin e .. të pronës shtetërore tek investitorët .. strategjik.

Vlen të përmendet se siç e përmendi edhe kryesuesi, vendet fqinje me të cilat Kosova konkurren sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja kanë legjislacion ... të avancuar dhe më të thjeshtësuar sa i përket tërheqjes dhe nxitjes së investimeve të huaja strategjike por gjithashtu edhe sa i përket bartjes së pronës së paluajtshme shtetërore tek investuesit potencial strategjik.

Zakonisht ata kanë procedura më të thjeshta sa i përket ... pronës shtetërore të investuesit ku zakonisht është një çmimi simbolik dhe në të shumtën e rasteve tejkalohen apo shmangen procedurat tenderuese dhe të gjata të prokurimit publik. Pra, objektivi i këtij projektligji është krijimi i bazë së mirëfilltë ligjore për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në sektorët e caktuar të ekonomisë, mirëpo të cilët janë me potencial të lartë zhvillimorë.

Ne i kemi identifikua 14 sektorë, mirëpo megjithatë është çështje e diskutimit dhe pajtona me kryesuesin që mund disa sektorë të ... apo edhe të shmangen nga ky ligj në mënyrë që të fokusohemi vetëm në sektorët të cilët janë me prioritet të lartë zhvillimor. Pra, ideja e këtij projektligji është që të thjeshtësohen procedurat, të përshpejtohen dhe të krijohen sa më tepër favorizime në mënyrë që një biznes të hapet sa më shpejtë dhe të bëhet realitet.

Gjithashtu ideja dhe qëllimi i këtij projektligji është që prona shtetërore, Qeveria e Republikës së Kosovës të mund të hyjë në negocita të drejtpërdrejta me investitorët potencial strategjik, kuptohet vetëm investitorët të cilët kualifikohen si stregjik nëpërmjet këtij projektligji, kriterëve dhe procedura të cilët janë të parapara me këtë projektligj në mënyrë që investimi strategjik të

ndodhë sa më shpejtë që të është e mundur për arsye se një ndër shqetësimet dhe ankesat e investorëve të huaj sidomos ka qenë që procedurat për fillimin e një biznesi dhe realizimi të një biznesi në Republikën e Kosovës sidomos qasja në pronën është e gjatë, e komplikuar dhe kjo vonon procesin e fillimit dhe zhvillimit të një biznesi në Republikën e Kosovës.

Gjigjashu me këtë projektligj janë të themeluara edhe organet apo institucionet të cilat do të merren me fillimin, .. do ta bëjnë mbikëqyrjen strikte se një investor potencial strategjik a po i përmbahet marrëveshjes së lidhur me Qeverinë e Republikës sa i përket kushteve, kriterëve të investimit strategjik dhe ligjin në një nen të caktuar parashih edhe mundësitë që në rast të shmangies aspo shkeljes së kriterëve dhe marrëveshjes gjithashtu mund të revokohet vendimi që një investor e ka fitua statusin e investitorit strategjik.

Unë po e përfundoj këtu duke qenë të bindur se me miratimin e këtij ligji Kosova do të avancoj strukturën ligjore sa i përket përmirësimit .. biznesor për investimet vendore dhe të huaja strategjike mirëpo gjithmonë duke shpresuar se ky projektligj ka ende hapësirë për amendamentimin këtu në Komisionin Parlamentar për Zhvillim ekonomik dhe do të begatohet dhe do të jetë një ligj sa më cilësorë dhe funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bllaca!

Pra u bë një shpjegim. Lumnije!

LUMNIJE HASHANI: Përshëndetje për të gjithë,

Unë jam Lumnije Hashani, prej Odës Ekonomike të Kosovës.

Ne e vlerësojmë si shumë të rëndësishëm këtë projektligj sepse me anë të këtij projektligji nxiten investime të jashtme në Republikën e Kosovës.

Në konsultim me bizneset të cilat i kemi pasur si rrjedhojë e takimeve të cilat i njoftojmë për ndryshimet sa i përket çështjes së legjislacionit.

Ne kemi has te neni 4, kërkojmë që të ristrukturohen sektorët dhe të fuzionohen në sektor të përafërt. Për shembull sektori i sportit dhe rekreacioni të fuzionohet në sektorin e turizmit. Mandej, sektori bujqësia, të fuzionohet me industrinë e ushqimit, telekomunikacioni me teknologjinë industriale e tjerë. Por sa i përket tek neni 4, shumave të cilat janë paraqitur mendojmë se vlerat janë shumë të larta të cilat janë të papërballueshme për investorët të cilët investojnë në Kosovë. Për shembull në fushën e turizmit janë vlera të mëdha për të investuar, prandaj propozojmë që këto vlera të ulen.

Sa i përket nenit 7, për zbatimin sa më efikas të këtij ligji kërkojmë që Komisioni ndërmënyor për investime strategjike të kryesohet nga kryeministri i Kosovës. Ku ne si Odë Ekonomike edhe më herët kemi kërkuar që Agjencia për promovimin e investimeve të bëhet pjesë e Zyrës së

kryeministrit sepse ka shumë adresa të cilat kanë për detyrë investimet të huaja ku po sjellin huti edhe po ndikojnë negativisht tek bizneset.

Te neni 20, propozojmë se aty ku thuhet në funksion të investimeve strategjike në Republikën e Kosovës mund të krijohet lista e projekteve strategjike. Ne propozojmë që fjala “mund” të zëvendësohet me fjalën “duhet”. Pra duhet të krijohet lista e projekteve strategjike.

Te neni 24, sa i përket kohëzgjatjes së drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e subjektit investues ne propozojmë që e drejta për shfrytëzimin e pronës të zgjatet nga 40 vite në 99 vite, për arsye se është kohë e shkurt që investitori t’i kthej investimet e veta apo të fitoj benefite brenda këtij afat.

Te neni 27, te afati. Ne kërkojmë që të hiqet krejt ky afat apo të zgjatet. Për arsye se deri ndoshta 2019 ose 2020 mund të ... investitorë të huaj, prandaj ky ja cungon të drejtën investitorëve për të aplikuar apo për këtë të drejtë.

Këto janë vetëm me pika të shkurta sa i përket propozimeve nga ana e biznesit, nga ana e Odës ekonomike. Ne mendojmë që të detajua do t’i sjellim me shkrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonjusha Hashani! Urdhëroni!

BERAT THAÇI: Unë jam Berat Thaçi, prej Institutit GAP.

Siç e cekim edhe udhëheqësi i Komisionit, Instituti GAP duke parë rëndësinë e këtij ligji ka filluar ta analizoj këtë ligj dhe të krahasoj me ligjet regjionale që nga dhjetori i vitit të kaluar.

Në analizën të cilën e kemi shpërndarë tek Komisioni kemi krahasuar Projektligjin për investime strategjike në Kosovë me dy ligje të tjera në rajon, pra Kroacia dhe Shqipëria. Njëkohësisht do të thotë këto janë dy vendet në rajon të cilat e kanë një ligj të ngjashëm me Kosovën.

Analiza jonë është fokusuar më shumë në aspektin ekonomik dhe nuk merr parasysh përputhjen e ligjit me legjislacionin e BE-së.

Mirëpo në vijim do të përmendi disa prej të gjeturave kryesore sa i përket suksesit të kësaj forme në tërheqjen e investimeve të huaja dhe të formave të tjera siç janë ... financiare të cilat përdoren nga shtetet fqinje siç janë Serbia dhe Maqedonia.

Sa i përket suksesit të këtij ligji, pra Ligji për investime strategjike në Kroaci, ne kemi kontaktuar Agjencinë përnë Kroaci e cila merret me zbatimin e këtij ligji dhe shërben si qendër hua-stop shop për investitorët e huaj.

Dhe në bazë të përgjigjes së kësaj agjencie kemi pa se deri tash, që nga viti 2013 kur është aprovuar ky ligj në Kroaci, Kroacia ka pranuar diku rreth 115 aplikacione për t'u cilësuar si investitor strategjik. Vlera në total është rreth 1.6 bilionë euro që është një shumë e konsiderueshme, mirëpo gjatë komunikimit që e kemi pas me ekspertë të këtij agjencioni sugjerimi i tyre ka qenë se suksesi i ligjit varet shumë edhe nga rrethanat specifike të vendit. Pra, kopjimi i Ligjit të Kroacisë për Kosovën nuk siguron sukses të domosdoshëm në nxitjen e investimeve edhe për Kosovën.

Duhet të kemi parasysh se Kosova rangohet më së ulëti në rajon sa i përket ambientit të të bërit biznes dhe edhe studimet tjera tregojnë se suksesi në tërheqjen e investimeve në regjion varet shumë edhe nga kualiteti i fuqisë punëtore dhe ... e ekonomisë në përgjithësi do të thotë zbatimit i ligjit, kostoja e të bërit biznes etj.

Përveç Kroacisë i cili e ka këtë ligj kemi audituar incitivat financiare që jepen nga Serbia dhe Maqedonia si dy shtete konkurruese do të thotë në tërheqjen e investitorëve. Kemi pa që Maqedonia përdor një formë më ndryshe në tërheqjen e investitorëve ata ofrojnë incitiva të shumta financiare, siç janë: pushimet në tatimet në taksa, subvencionimi i ndërtimit të objektit, subvencionimi i pagave të punëtorëve, trajnimeve apo lirimet në kontributet e punëtorëve. Dhe, kjo formë është treguar është mjaft e suksesshme në Maqedoni dhe në Serbi njëkohësisht. Pas hyrjes në fuqi të këtyre incitivave financiare në Maqedoni, në vitin 2006 investimet e huaja direkte janë rritur në mënyrë të theksuar dhe në vitin pasues, vitin 2007 do të thotë investimet e huaja direkte kanë qenë në Maqedoni në nivelin më të lartë rreth 506 milionë euro.

Njëjtë edhe në Serbi pakoja financiare për investitorë ka hyrë në fuqi në vitin 2014 dhe në vitin pasues kemi pa një ngritje të investimeve përrreth 18%. Pra, nuk është vetëm ky ligj si formë për të tërhequr investimet e huaja ka edhe opsione tjera. Jemi të vetëdijshëm që tash Ministria e Financave ka filluar të hartojë një udhëzim administrativ për pushimet tatimore dhe mendojmë se kjo është mënyra e duhur për të tërhequr investitorët e huaj dhe të brendshëm, të paktën kështu tregojnë do të thotë përvojat e rajonit.

Para se të shkoj te rekomandimet, pra mendojmë që ka Ligji për investimet strategjike i bart disa rreziqe për abuzime me pronën shtetërore dhe ne kemi rekomanduar se ky ligj të mos lejojë bartjen, do të thotë në shfrytëzim të pronës shtetërore pa aprovimin e Kuvendit ose procedurat e prokurimit publik.

Kuvendi i Kosovës e kemi pa si institucion që do të thotë ofron një siguri më të lartë në uljen e abuzimit me pronë shtetërore. Një rekomandim tjetër sa i përket këtij ligji është qartësimi i kriterëve të numri i të punësuarave, për shembull në ligj nuk specifikohet nëse të punësuarit duhet të jenë të punësuar të përkohshëm ose part time apo sa është gjatësia e kontratës të këtyre punëtorëve, sepse investitori vetëm për të përmbushur këtë kriter mund të punësojë disa individë

për një kohë shumë të shkurtër edhe ai thotë i kam punësuar kaq persona, prandaj është esenciale që te kriteret të specifikohet edhe gjatësia e kontratës edhe nëse këta punëtorë duhet të jenë të punësuar me orar të plotë.

Rekomandim tjetër te neni 6 është se aty specifikohet një varg i dokumenteve të cilat duhet të ofrohen nga investitori, rekomandimi jonë në këtë rast është që të gjitha këto dokumente duhet të bëhen transparente në një ueb faqe, kjo mund të jetë në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Rritja e transparencës në proces i ul edhe dyshimet e publikut edhe mundësit për me abuzu në proces do të thotë nga akterët relevant. Gjithashtu, duhet të definohet më qartë edhe metodat e futjes së sektorit të ri në këtë ligj, do të thotë të caktohen kriteret qysh tani që mos të improvizojmë pastaj me ligjin.

Rekomandim tjetër jashtë këtij ligji që është po ashtu i rëndësishëm në suksesin e tërheqjes së investimeve ne si shtet duhet të vazhdojmë të punojmë në zbatimin e përmirësimit, do të thotë në përmirësimin e zbatimit të kontratave apo sundimin e ligjit, në përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore dhe gjithashtu duhet të jemi, duhet të hartojmë incentiva tjera financiare sepse shtetet në regjion janë duke e bërë këtë dhe ne duhet të konkurrojmë me ta në tërheqjen e investorëve. Faleminderit, shumë!

KRYESUES MUHAMET MUSTAFA, KRYETAR I KOMISIONIT: Faleminderit!

Ju kërkohet falje që u vonova pak po po shoh që keni hy mirë në temë dhe ajo është kryesore. Urdhëroni ju lutem edhe prezantohuni për shkak edhe të procesit që do të mbajmë edhe të konsultojmë transkriptin.

BRAHIM SELIMAJ: Quhem Ibrahim Selimaj vi nga Kompania “Elsa” tani jam edhe kryetar i Shoqatës Ndërtimtarëve dhe Prodhuesëve të materialit ndërtimor. Ky material është një material i punuar ky projektligj i punuar ka material shumë të mirë i cili mund të lavdërohem me të, por ka mundësi që edhe të bëjmë korrigjime dhe përmirësime edhe parafolësit tjetër, të cilët kishin disa vërejtje sikurse Lumnja që ishte nga Oda Ekonomike dhe kolegja tjetër, nuk dua t’i përsëris ato se afati i limitimit etj., etj.

Të investorëve sepse nuk mund t’ua ndalim ne njerëzve neve investimet pas 2018 por duhet të vazhdojë edhe më tutje edhe me theks ... edhe njëherë po e plotësoj atë çka e tha Lumja, por unë kam një vërejtje e cila ma merr mendja do një studim pak më të mirë, sepse investimet në bujqësi që gjenerojnë më së shumti vende pune që tani në Kosovë janë më potenciale për një ardhmëri, një zhvillim të shpejtë të vrullshëm janë të parapara ... nuk dua të them se të tjerët a duhet apo nuk duhet, sepse në sektorët tjerë çdo kund dhashtë zoti që me qenë edhe më shumë, por me theks të posaçëm neve na intereson tani për tani zhvillimi ekonomik më i shpejt që i nevojitet Kosovës dhe unë mendoj që sidomos në bujqësi që ishte dashur një analizë pak më e thukët dhe investim më i madh, sepse këtu mund të vijnë shumë shpejt deri te një investim dhe kapitalizim i

saj dhe mua ma merr mendja që analiza nuk është bërë mirë kur është fjala te asnjëri prej sektorëve të cilët janë që punësimi ta zëmë, që prapë po kthehem te bujqësia.

Thotë “me ... milionë mund të punësohen 50 vende të punës”, duhet një analizë ju lutem shumë e madhe se këtu është bërë një gabim, ose analiza nuk është bërë si duhet. Sepse, këtë me dal me këto shifra është qesharake. Në secilin sektor këtu që është bërë ky analizë unë mendoj se duhet një analizë tjetër me ju bë vendeve të punës dhe të eliminohen këto sepse me kah 50-60 vende punës dhe me 30 milionë investim kjo është anomali.

Unë flas edhe prej ekonomije edhe prej zhvillimit se tash e 35 vjet punoj në ekonomi dhe është dashur këtu ma merr mendja që është bërë far lëshimi këtu se kjo me dal këtu me këto shifra këtu janë gjëra të cilat nuk na kanë hije. Ka shumë gjëra, të cilat mund t’i them por unë do t’i jap edhe me shkrim nuk do t’u zgjas me këtë por me theks të posaçëm tek përcaktimi i investimeve kapitale unë mendoj që ishte dashur zoti kryetar dhe paneli tjetër, ishte dashur që të mendojë më mirë sa i përket pikave se ku mund të gjenerojnë vende të punës tani për tani neve me theks të posaçëm duhet të ndalemi në atë. Dhe unë mendoj që më së shumti që duhet edhe i nevojitet Kosovës është bujqësia, sepse e kemi kapital të gatshëm të cilin mund ta shfrytëzojmë. Faleminderit prej jush!

KRYETARI: Faleminderit, vazhdojmë më tutje.

DREN AJETI: Përshëndetje i nderuari kryetar,
Të nderuar anëtarë të komisionit,
Të nderuar pjesëmarrës,

Unë quhem Dren Ajeti jam nga Grupi për studime juridike dhe politike. Grupi për studime juridike dhe politike në bashkëpunim me GAP dhe .. ka bërë disa vërejtje lidhur me ligjin në fjalë, dhe janë përafërsisht 12 rekomandime të cilët ne i kemi për ligjin, mirëpo nuk do të futem në secilin nen mirëpo te ato më kryesore, sepse do të thotë propozimet tona ia kemi dërguar edhe komisionit edhe të gjithë anëtarëve të komisionit. Lidhur me nenin 18.3 që bën fjalë për pronën publike dhe kur ky komision ndërministror mund të ua jap një investuesi strategjik ne mendojmë se këtu duhet të hapet do të thotë një tender lidhur me dhënien e pronës publike.

Në asnjë mënyrë nuk mund të anashkalohen procedurat tenderuese prandaj, propozojmë që neni 18.3 të fshihet tërësisht dhe të rishkruhet sipas këtij propozimi përjashtimisht prona e Republikës së Kosovës mund të vihet në dispozicion të investitorëve strategjik vetëm pasi të ketë kaluar nëpër procedurat e rregullat tenderuese të përcaktuara me legjislacionin adekuat të Kosovës i hartuar në pajtim me çmimin e tregut i cili është përcaktuar nga ekspertët e autorizuar në rastin e hartimit të legjislacionit..

Kemi bërë disa krahasime me vendet e tjera të rajonit, por edhe me vendet tjera të cilat nuk e kanë decidivisht një ligj për investimet strategjike, por që kanë nene ose më mirë me thënë legjislacion të përafërt dhe aty kemi të drejtë se si për shembull në Kroaci pasi është bërë një ligj i tillë menjëherë ka filluar amendamenti i ligjit pra me vendet e tjera ka filluar amendamenti i ligjit pikërisht mbi këtë problem, sepse edhe vendet tjera fillimisht kanë përcaktuar që të mos ketë tenderë kur jepen prona publike, por më vonë kanë parë që diçka e tillë është e nevojshme.

Po ashtu, do të thotë propozojmë që ju me kriteret për përzgjedhjen e investorëve strategjik të bëhet një ndryshim sepse aktualisht në ligj janë kriteret kuantitative dhe ndoshta aty do të duhej të ndryshohet diçka dhe të merren edhe kriteret tjera, për shembull lidhur me atë se sa dëshiron një investor të investojë në Kosovë për çka do të investojë në Kosovë, shumë më e vlefshme do të ishte për Republikën tonë nëse do të investonte një firmë e njohur e cila investon 10 milionë euro se sa një firmë për shembull që është e gatshme të investojë 100 milionë euro brenda 10 vjetëve largohet ose ka një reputacion shumë të keq në vendet e ndryshme.

Po ashtu, propozojmë që të përcaktohet një periudhë kohore brenda së cilës parashihet që duhet të bëhen këto investime strategjike. Për shembull deri në cilin vit parashihen të mirëpreiten investimet strategjike. Kjo do ta lehtësonte punën e këtij ligji dhe po ashtu do të thotë një veprim të tillë e ka ndërmarrë edhe shtetet e tjera të cilat kanë bërë një parashikim se lidhur me ato investime strategjike sa do të zgjasin investimet strategjike dhe kështu edhe institucionet shtetërore mund të bëjnë një parashikim dhe mund të bëjnë një vlerësim se sa do të ngritet niveli i papunësisë ose niveli i punësimit dhe veprimet e tjera.

E rëndësishme është që të përcaktohet edhe një nen i cili e rregullon konfliktin e interesit, aktualisht nuk ka asnjë dispozitë ligjore e cila e parandalon konfliktin e interesit lidhur me investimet strategjike. Po i kaloj disa pika që të mos e zgjas shumë. E rëndësishme është që projektligji në fjalë duhet t'i ofrojë mbrojtjen investorëve strategjik në rast se ndryshon legjislacioni aktual i Kosovës, po e marr vetëm një shembull ku një investori i caktuar investon në Kosovë lidhur me do të thotë është një legjislacion i caktuar dhe pas 5-6 vjetëve ai legjislacioni të ndryshojë të mund të shkaktojë probleme shumë të mëdha tek investitorin propozojmë që të ofrohet një lloj përkrahje, ose më mirë me thënë një lloj anashkalimi i legjislacionit të ri me qëllim që investorët aktual të jenë pak a shumë të mbrojtur dhe të dinë përafërsisht se çfarë do t'i pres në të ardhmen.

Dhe, vendet e tjera po ashtu e kanë pasur e kanë një nen të caktuar i cili përcakton se cilat janë investimet e ndaluara. Fatkeqësisht Republika e Kosovës ose ky projektligj nuk e ka të përcaktuar se çfarë do të ndalohet me investimet dhe mendojmë që pika kryesore e ligjit përveç këtyre tjerave është edhe neni 7 i projektligjit i cili tregon për funksionimin e komitetit të investimet strategjike.

Fatkeqësisht në këtë nen nuk është futur Avokati i Popullit, nuk është futur ministri përgjegjës për çështje të energjisë, ministri përgjegjës për infrastrukturë dhe ne mendojmë se do të ishte dhe është e rëndësishme që gjithsesi pjesë e këtij komisioni të jenë edhe anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik mund të jetë 1-2 por gjithsesi edhe ata do të jenë pjesë e atij komisioni, dhe gjithsesi çdo gjë që do të ndodh në këtë proces duhet të jetë sa më i hapur, sa më transparent dhe po ashtu të përcillet edhe nga pse jo edhe nga përfaqësues i shoqërisë civile.

Dhe më e rëndësishme do të thotë që ne mendojmë se do të duhej të cekin në nenin 7 është rishkrimi, ose më mirë me thënë përfshirja e një neni që do të mund të duhej kështu anëtarët e komisionit të investimeve strategjike nuk mund të jenë të përfshirë në çfarëdo forme në aktivitetet e investitorëve strategjik pa kaluar katër vjet nga pjesëmarrja në vendimmarrje dhe lidhur me këta investitorë. Mendojmë që kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse ka ndodh do të thotë edhe në vendet e tjera që një ministër i caktuar ose një anëtarë i caktuar i një komisioni ka lobuar shumë më shumë për një investitor të caktuar dhe kur është larguar prej postit të tij veç kur e kanë parë që është në bordin e drejtorëve ose është bërë menaxher dhe mendoj që diçka e tillë do të duhej të ndalohej me ligj, do të thotë me projektligjin aktual. Edhe një herë thash, e keni vërejtur edhe ju anëtarët e komisionit, që lidhur me kriteret duhet të përcaktohen gjithsesi kriteret të tjera, kriteret shumë më të bazuara dhe që do t'i shërbejnë këtij projektligji. Fatkeqësisht, jemi vonuar ndoshta pak me projektligjin, mirëpo siç thonë, më mirë vonë se kurrë. Shpresojmë që ky projektligj do të nxisë që në Kosovë të shtohen investimet dhe të fillojë ngritja dhe zhvillimi ekonomik. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit.)

KRYETARI: Deputeti Besim Beqaj ka disa intervenime.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj falje, por unë kam edhe një takim tjetër dhe më duhet të shkoj, por më parë desha ta jap mendimin tim personal, sa i përket ligjit.

U diskutuan shumë, pothuajse jemi në një formë të gjithë duke tentuar që ta përmirësojmë ligjin në fjalë. Unë vlerësoj shumë edhe studimin krahasues që e ka bërë GAP-i. Dua t'i falënderoj edhe punën e përbashkët që e kemi bërë me grupin për studime politike dhe ligjore, sepse na kanë ndihmuar. Na kanë ndihmuar për të parë një pasqyrë edhe të vendeve tjera dhe kjo realisht na ka dhënë një pasqyrë tjetër për qartësimin e kriterëve, të cilat duhet t'i marrim parasysh.

Unë dua të besoj që neni 2 duhet të riformulohet në mënyrë goxha substanciale. Duke parë krahasimet ne kemi limitime, për shembull, disa shtete kanë numër shumë më të vogël, unë jam në favor të përcaktimit të kriterëve strategjike, respektivisht sektorëve strategjikë, të cilët do të përcaktohen me ligj. Ndërsa, nënsektorët, sikur i kanë disa prej shteteve, të përcaktohen me vendim të Qeverisë. Pra, të themi se ajo mund të bëhet, mirëpo të përcaktojmë sektorët me ligj, ndërsa nënsektorët duhet të rregullohen me vendim të Qeverisë, jo të lihet kjo punë kështu e

padefinuar, sepse siç e kemi nenin 2, do të thotë çdo investim potencial në Kosovë mund të aplikojë për të marrë statusin. Dhe, këtu pastaj mund të flasim për kriteret, të cilat besoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Unë nuk besoj se është bërë ndonjë analizë e saktë, e thuktë, sa i përket investimit të nevojshëm për një vend pune, në asnjë sektor. U ngrit këtu çështja e bujqësisë, por asnjë sektor nuk ka relevancë të plotë të kostos, e cila duhet të bëhet për krijimin e një vendi pune. Dhe këtë, nëse analizojmë mirë krahasimin që e kanë bërë shoqëria civile, do të shihet që, po e zëmë në Kroaci, që është vend shumë më turistik se sa ne, kërkohet investim që është më mirë i definuar se sa tek ne, nëse është fjala për investime të cilat janë në sektorin e turizmit.

Pra, ne kemi numër shumë më të vogël të të punësuarve, për investime shumë më të mëdha, që realisht ne nuk presim një veprim të tillë. Besoj që duhet të rishikohen në mënyrë të saktësuar me analizë paraprake sa është kostoja në një sektor për të krijuar vende pune dhe konform asaj ta vëmë fokusin në vendin e punës, sepse neve, fundi i fundit, Ligji strategjik përveç që na kërkon investime kërkon dhe krijim të vendeve të punës. Ne dëshirojmë ta shohim efektin duke krijuar vende pune, jo vetëm për investitorin dhe atë që u tha nga kolegët, që reputacioni i investitorit potencial është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Pra, në këtë drejtim besoj se duhet ta diskutojmë.

U diskutua dhe çështja e aprovimit të Kuvendit për investime për shfrytëzim të dhënies së paluejtshmërisë në shfrytëzim. Në bazë të praktikave që nëpër vende tjera është për një investim të caktuar, për një sasi të caktuar të investimeve, duhet të kërkohet nga Kuvendi dhe vendim paraprak, kjo për të gjitha investimet. Dhe, me këtë unë pajtohem që ndoshta për investimet, të cilat janë me interes strategjik për shtetin, jo ndoshta afatshkurtë dhe afatmesëm, për shkak se investitorët kërkojnë siguri të mosrevokimit të vendimit për dhënien e statusit strategjik.

Çka nënkupton revokimi i vendimit për... ndërrohet Qeveria, vjen një qeveri tjetër, e ka një status tjetër dhe e heq. Dhe, kjo dërgon një mesazh goxha diskutabil tek investitorët potencialë, sepse nuk mund të jetë asnjëherë i sigurt për investime të mëdha, me interes strategjik, duhet njëfarë lloj parapëlqimi, por jo ndoshta me shkua me krejt prokurim, mirëpo siç e dini, thotë: nëpër vende të ndryshme, Kroacia e disa prej vendeve kanë me ftesë publike, jo me garë, por ftesë publike dhe pastaj mbi bazën e ftesës publike përcaktohen kriteret në bazë të të cilave do të jepet toka. Pra, shkurtohet shumë procedura, por që gjithmonë kemi një garë e cila parimisht paraprin dhe ia jep një epitë më të fuqishëm procesit.

Definitivisht, duhet të rregullohet konflikti i interesit, nuk është i rregulluar aspak me ligj. Duhet të rregullohet edhe raporti i marrjes së vendimeve në mes të Agjencisë për Promovim të Investimeve dhe Qeverisë, në ligj është e paqartë, së paku unë s'kam mundur ta kuptoj mirë, sepse në disa vende thuhet "merr vendim Komisioni", thuhet që është Agjencioni dhe disa vendime mund t'i marrë Qeveria. Do të thotë, ligji nuk guxon të lejojë fjalën "mund". Parimisht, në ligj ne nuk e përdorim, do të thotë ligji është përcaktues, nuk është ligji që jep alternativa të ndryshme, por është dokument përcaktues.

Dhe mbi të gjitha, kisha dashur që atë që u tha nga kolegu Ajeti, dua ta vlerësoj shumë, që është mbrojtja e investitorit potencial. Përveç që do të bëhet, në rast se shkohet me vendim në

Parlament për investime strategjike, do të duhet të vihet në fokus Ligji për investime të huaja, që është ligj i cili mbizotëron ligjet tjera në rast të investitorëve të huaj, ai duhet të jetë valid, do të duhet të theksohet këtu, i cili realisht në mënyrë automatike me një fjali mund ta rregullojmë ligjin, që ata nuk bien pre e shfrytëzimit të ligjeve, të cilat do të ratifikojnë vendimet paraprake.

Pra, ne besoj që pas këtij debati do t'i marrim të gjitha nga ju me shkrim dhe do ta bëjmë një ligj, të cilin pastaj do ta analizojmë edhe ne njëherë në komision, mirë e mirë, por si ide e si nismë besoj që është e mirë, ligji ka nevojë për t'u qartësua në detaje. Për momentin nuk është i tillë dhe unë do të vazhdoj edhe si pjesë e grupit punues, por edhe si pjesë e komisionit, të merrem me përkushtim të theksuar për ta bërë një ligj, që do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik. Edhe një herë, ju kërkoj falje që më duhet të shkoj, por që desha të them edhe mendimin tim personal për këtë. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit edhe për modelimin fillestar edhe për diskutim! Zoti Grainca mandej zoti Latif Kryeziu e ka fjalën. Urdhëroni, zoti Grainca. Sot keni përparësi ju, ne nuk kemi kohë. Ne do të kemi mjaft kohë për të diskutuar, mirëpo është për ta nxitur diskutimin, nganjëherë me i hap do tema është e dobishme.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Shumë prej problemeve apo fushës që rregullon ky ligj, tashmë u përmenden, megjithatë unë po dua t'i ndaj me ju disa nga shqetësimet e mija, që i kam ngritur edhe në mbledhjet e kaluara të Komisionit për Zhvillim Ekonomik e që u përmendën këtu edhe nga parafolësit.

Poenta kryesore, për mua, qëndron te ajo se ky ligj lë për të dëshiruar, veçanërisht tek pjesa që flet për kriteret. Mendoj se Kosova dhe vendi ynë nuk duhet t'i lejojë vetes një komoditet të tillë që të përcaktojë kriteret që realisht e pengojnë zhvillimin ekonomik dhe rritjen e investimeve, veçanërisht kriteret financiare, për arsye se kriteret financiare që janë vendosur këtu, po qe se u referohemi praktikave dhe jetës reale, vërtet janë të larta.

Është bërë rregull në vendin tonë, që të bëjmë dhe të shkruajmë ligje nga zyra pa e njohur realitetin dhe koston e investimeve. Të thuash se në fushën e logjistikës limiti apo minimumi për një investim është 30 milionë euro, për t'u konsideruar si investim strategjik, mendoj se është shumë i madh, për faktin se e para që e pengon, ju e dini nëse keni bërë një hulumtim në fushën e energjisë, kostoja për një MW të energjisë së rinovueshme shkon 1,2 milionë, 1,5... e këto tjerat pak më shtrenjtë. Domethënë, ne presim që dikush të vijë e të investojë 30 milionë euro dhe eliminojmë dikë që mund të vijë e të investojë 5 milionë euro. A është më mirë, tash shtrohet dilema, të kemi dhjetë investitorë me nga 5 milionë euro, apo të presim një që nuk do vijë kurrë e të investojë 30 milionë euro. Mendoj që kjo është një prej problemeve.

Po ashtu, janë edhe sektorë të tjerë, u përmend bujqësia, industria, industria ushqimore është vënë 5 milionë. Po, a e dimë ne që me 5 milionë çfarë investimi mund të bëjmë në sektorin e ushqimeve? Kur e dimë, për shembull, se vendet tjera edhe këtu përreth edhe... iu referua më herët Besimi, Kroacisë... për shembull ne i kemi lënë, e kemi futur turizmin e kemi hequr pylltarinë. Domethënë, këto dyja ose duhet të shkojnë bashkë, ose nuk duhet të jenë fare.

Po e shihni çfarë po bën vendi ynë në përpjekjet për t'u anëtarësuar në mekanizmat dhe institucionet e sportit, e kemi lënë sportin jashtë kur është atraksion për investitorë të mundshëm dhe e kemi Ligjin për sportin, i cili u miratuar më herët, që i lejon pastaj edhe donacionet dhe gjërat tjera.

Prandaj, mendoj që kjo fushë do, nëse themi për shembull, se Kroacia në shumë fusha ka vënë limite 2 milionë për të investuar, çfarë komoditeti kemi ne që të vendosim, për shembull, 30 milionë në telekomunikacion, 5 milionë në arsim, 10 milionë në shëndetësi?...

Mendoj që duhet ta ulim këtë kriter, sepse i pengon realisht investimet.

Unë kam edhe disa shqetësime tjera, që lidhen me pika të veçanta të këtij neni, por që besoj se edhe ju do i thoni edhe më vonë, u përmend prona, u përmend implikimi i Qeverisë në dhënien e asistencës, deri në çfarë niveli duhet të shkojë asistenca e Qeverisë për një investitor strategjik, deri ku nuk kalohet ajo vija e kuqe, ku mund pastaj të konsiderohet konflikt interesi, si dhe periudha kohore. Unë mendoj, ideja ime është, që ky ligj të mos përcaktohet me periudhë kohore, por të lihet për një periudhë sa më të gjatë kohore, sepse ne kemi çdo ditë nevojë për investime. Ndoshta, në një të ardhme do të konsiderojmë se kemi mjaftë investitorë dhe ia lëmë Qeverisë ose Kuvendit të vendos për ta ndryshuar këtë ligj.

Ajo që më së shumti e pengon investimin dhe investitorët që të vijnë në Kosovë, është fusha e sigurisë. Nuk po flasim vetëm për sigurinë financiare, sigurinë e investimit, por edhe vetë siguria fizike e investitorëve. Ju po shihni se sot në vendin tonë, ndoshta s'ka fare investitorë, ose ka shumë pak, për shkak të rreziqeve që kanë në shkallën e rrezikut fizik, që u kanoset investimeve të tyre.

Prandaj, mendoj se kjo fushë duhet të rregullohet, edhe pse pak e rregullon ai Ligji për investime të huaja, duhet të rregullohet më mirë, se cilat janë mekanizmat që ofron Qeveria e Kosovës për sigurimin e investitorëve? A duhet të bëhet një fond i veçantë i garancive? A duhet të jepet garanci shtetërore, a garanci bankare, apo çfarë duhet të japë shteti, që një investitor ta ndjejë veten komod. Ne nuk mund t'ia garantojmë suksesin e biznesit, sepse është ekonomi e tregut, por ne mund t'ia garantojmë, që nëse dikush shkon e ia dëmton biznesin apo... s'po flas për forcat "vis-majority" që quhen, për këto në kushte dhe rrethana normale.

U përmend edhe transparenca, unë e kam thënë edhe më herët, po e them dhe tash, është e domosdoshme të rritet transparenca, por nuk jam tek ajo që shoqëria civile të përfshihet në vendimmarrje, për arsye se shoqëria civile do të duhej të përfshihet në mbikëqyrje, në vlerësim të procedurave, në rritjen e transparencës, të monitorojnë procesin, kurse propozimi im, sepse s'ka një bazë ligjore për t'i përfshirë, kurse propozimi im i drejtpërdrejtë te kjo fusha e transparencës, është që me çdo kusht në këtë Komitetin për Investime Strategjike të përfshihen përfaqësuesit e opozitës parlamentare, kushdo qoftë, sot është dikush, nesër dikush tjetër, por opozita të ketë përfaqësuesit e tyre në transparenca. Kjo ndoshta e shkurton procedurën, që të mos ketë nevojë të shkohet në Kuvend pastaj për çdo vendim të thjeshtë dhe me u rritë shkalla e burokracisë. Faleminderit!

LATIF KRYEZIU: Latif Kryeziu nga kompania “Al-Petrol”. Jo vetëm me derivate, por merrem edhe me ndërtime, hotelieri, artikuj ushqimorë në përgjithësi.

Unë e përshëndes këtë iniciativë në kuptimin që nesër të gjendemi këtu dhe të kontribuojmë në këtë ligj, por unë konsideroj që ne së pari duhet të evidentojmë sektorët tanë strategjikë dhe të dëgjojmë fjalën e ekspertëve dhe njerëzve, të cilët vijnë prej atyre sektorëve atje, duhet thjeshtë të jetë determinuese, në mënyrë që të shihen të gjitha ato kritere, ato gjëra që do të inkorporoheshin në këtë ligj, jo vetëm juristë por të lëmenjve të caktuar. Unë flas në periudhat përpara, kur kemi pasur, zoti kryetar i Komisionit e di se ne kemi pasur edhe Institutin e Zhvillimit Ekonomik pranë Qeverisë, flas të Kuvendit të Kosovës, mendoj se tash është e udhës të kemi edhe një institut, i cili i përcjell këto gjëra, i cili në koordinimjo vetëm këtë ligj për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik se ne kur po flasim për strategjinë e zhvillimit të sektorëve strategjikë ne duhet të shikojmë se si e kemi edhe ekonominë e tanishme. Domethënë kemi nevojë për një konsolidim të ekonomisë por e kemi edhe strategjinë në këtë ligj tash të zhvillimit të sektorëve strategjikë, kemi tash edhe strategjinë e zhvillimit edhe të sektorit privat që e kemi filluar, atëherë ne çka duhet të ndërmarrim? Këto ligje, ne po mendojmë se po i biem duhet të parashohim disa kushte, disa gjëra që kemi me pas rezultat, në çka? Në zhvillimin ekonomik, në punësim dhe të rritjes ekonomike të shtetit.

Sigurisht se këtë që e përmendi, siguria e të gjitha këto, secili investitor kur të vjen ka me thënë se në cilin, në çfarë shteti jam. Flas, a është një shtet i ekonomisë së tregut dhe e shtetit ligjor apo nuk është. Tash neve çka na duhet krahas kësaj, se sigurisht ne me këtë ligj, nesër do të jetë i varfër, sado që të jetë i qëlluar në kuptim me të gjitha kriteret, nëse s’kemi siguruar një infrastrukturë të përgjithshme, që nesër ka mundësi të implementohet.

Çka vuajmë ne sot, si Kosovë, për çështjet të cilat nuk i kemi në rregull, po flas nga aspekti ekonomik. Infrastruktura ligjore, më kujtohet një herë ... Shpilak, kryetar i sindikatës, më tha dhe po e them decidivisht: “praksa shumom, normativni akti drugom”! Domethënë ne, për nga praktika, besoni që jemi shumë mirë, në asfalt jemi dhe infrastruktura në mal është.

Të ju them veç shikoni çështjen e licencave. Ne kur po bisedojmë, licencat në çdo vjet duhet. Po normal, tjetra, s’parashihen humbjet, për shembull në asnjë sektor. Për shembull burokracitë të cilat janë të shumta për përqindje... Nejse, unë po flas, ndoshta nëse nuk formojmë nesër trupa nëpër komuna të cilat do të merren direkt me investitorët e huaj, më besoni se ai do të ikë me pëlqimin e parë kur kërkon ose prej KEDS-it ose prej “Batllavës” e nuk di prej kujt. Pse? Për ta nuk është e rëndësishme me u marrë me një pëlqim se i kanë punët tjera dhe s’ju duket kurrë ajo, e kjo për ne është shumë e rëndësishme. Atëherë, kush duhet me u marrë? Duhet me u marrë dikush, trupat sikur që e kemi si shembull praktik në Shqipëri – Tiranë, pranë asamblesë e ka formuar trupën e cila i përcjell investitorët e huaj. I pret dhe i përcjell, dhe i ndihmon që ata të mos bredhin poshtë e lartë.

Prandaj, përveç infrastrukturës ligjore, çka na duhet ne? Ne na duhet edhe politika jonë kreditore dhe fiskale. Edhe ato, s'i kemi kurrkund. Dhe duhet ato të jenë konform të një ekonomie të tregut.

Mos t'i numëroj sa, se unë i kam numëruar, dhe i ka edhe me shkrim ministri financave, përveç kësaj. Pastaj, e kemi problemin shumë më të madh, energjinë. Si e kemi çështjen me energji? Për shembull, ne e patëm një takim edhe me KEDS-in, atëherë pse s'e bëjmë atë që kemi mundësi, nëse s'kemi mjaft korrent, po pse s'e bëjmë, t'i qesim në grupin a ekonominë se neve të kemi rrymë për ekonomi. Dhe ajo mos të vuan. Dhe kur të vjen ai nesër, s'po e di a ka ardhur të zhvillojë biznesin e vet apo do të zhvillojë sigurimin e rrymës me marrë agregat që duhet sikur të jetë një fabrikë e veçantë. Ta zëmë ne i kemi 100 agregatë, duhet formuar, siç e kemi formuar një kompani që merret me menaxhimin vetëm të aggregateve. Prandaj, nëse në këtë drejtim ne, çfarëdo ligji të jetë i mirë ky, s'kemi siguruar këto gjëra, atëherë çka kemi bë?

Tjetra. Është shumë e rëndësishme që tash të orientohe mi sepse po na vuan ekonomia. Nuk kemi klasë punëtore adekuate me përgatitje profesionale, praktike dhe atë që duhet. E çka duhet? Duhet plan-programet e filluara në shkollat të mesme, që i kemi shkollat profesionale, mandej në fakultete, të orientohe mi në kuptim me nevojën e këtyre strategjive që po i parashohim tash menjëherë. Pse mos të jenë këto edhe në kohë, kur diskutojmë edhe për universitetin, dhe edhe shkollave të mesme profesionale dhe këto tjera, dhe ne s'bëjmë kurrgjë me këtë ligj, sepse ky me e mbajt, asgjë s'paraqet në veti.

Prandaj, në këtë drejtim duhet, për të ndodhë kjo duhet të jetë një institut të cilët njerëz nga aty vijnë e koorporohen nga teoria dhe praktika, për arsye se njerëzit e teorisë po na mbesin nganjëherë të çështjes teorike, sikur që e biem një ligj, të dimë sa është i zbatueshëm.

Unë flas dhe s'po them, por zotni Ibrahim tha 35 vjet, e unë po them 40 vjet në ekonomi, por asnjëherë s'mora pjesë që sa vite pas lufte në hartimin e ndonjë ligji, që t'kemi marrë pjesë në grupe punuese gjithmonë, që janë nga pjesa praktike, por janë edhe teorike, sepse edhe ne jemi duke kryer shkollat, besa jemi magjistër, jemi tamam me teori e praktikë që është problem dhe ndoshta duhet shkuar të gjejmë një kuadër diku në botë e me të ardh këtu, por këtu e ke e s'e shfrytëzon. Dhe këto politike duhet t'i ndërrojmë ne dhe duhet të fillojmë praktikisht në lidhje me këto çështje.

Unë flas dhe them, mos t'i lëmë ne faktorët x të panjohur, të cilët do ta bëjnë implementimin e këtyre ligjeve, dhe nuk dimë kush. Ose ta lëmë ne, apo domi ta kemi zbatimin e tij, apo do të kemi çka të kemi... Do të kemi një ekonomi të favorizuar. Do ta kemi ndoshta një ekonomi të kriminalizuar, në kuptimin, kur nuk janë kriteret ekonomike, e për të qenë kriteret ekonomike duhen njerëzit profesionistë, njerëz të përgjegjshëm, njerëz të cilët do të japin llogari diku dhe kanë me paraqitur rezultatet të cilat i kanë mbërri. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, prezantohuni!

GANI MALIQI: Unë jam Gani Maliqi, e përfaqësoj Kompaninë Peshter – Minings, e cila është pjesë e konglomeratit të Kompanisë Brykat nga Australia.

(Ndërhyrje)

Po, e kemi pasur një prezantim dhe ne merremi me hulumtime gjeologjike dhe me miniera dhe pas disa hulumtimeve të suksesshme që i kemi zhvilluar në një rajon të Kosovës, kemi ardhur në përfundim se jemi duke e kryer procesin e para fizibilitetit, mirëpo me qenë se ky projektligj është për investitorët strategjikë, ne mendojmë se duhet t'i qartësojmë me Qeverinë pjesë të ligjit të cilat duhet të futen në masa fiskale për studimin e fizibilitetit i cili do të bëhej më profitabil projekti në të ardhmen.

E kemi lexuar Projektligjin me vëmendje. Projektligji për ne është shumë i mirë, do të thotë, për të investuar në Kosovë dhe ne mendojmë se Kosova ka kapacitet shumë të madh në fushën e minierave pasi që është e pasur me pasuri minerale.

Projekti ynë, natyrisht, do të vazhdojë. Ne ia kemi dërguar edhe Komisionit tuaj përmes letrë, ku anëtarët e Komisionit tuaj, siç është zonja Sala Berisha, ka marrë pjesë dhe e ka përcjell projektin tonë dhe për këtë është më tepër e informuar.

Gjithashtu i kemi dërguar letër edhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë lidhur me pozicionin tonë dhe gjithmonë kompania jonë është e interesuar që të zbatojë transparencën dhe t'i informojë të gjithë faktorët relevantë në Kosovë që të mos ketë moskuptime ose keqkuptime në të ardhmen.

Natyrisht, neve na intereson të dimë se kur hyn në fuqi ligji dhe menjëherë ndoshta do të jemi eksperimenti i parë për të aplikuar si investitor strategjik.

E vetmja mangësi që mund të jetë në projektligj është se neve ballafaqohemi çdo ditë me problemin e licencave, lejeve dhe aprovimet e ndryshme nëpër komuna. Do të ishte mirë të gjendet një adresë, një pikë e vetme ku do t'i merrnim, do të thotë, të gjitha licencat sepse na duhet një kohë shumë e gjatë, e koha është për t'i marrë këto licenca, të cilat ne i marrim prapëseprapë, mirëpo shpenzojmë kohë.

Unë dëshiroj që ligji të miratohet dhe natyrisht të futemi në negociata me Qeverinë e Kosovës. Kaq kisha unë!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, ju nga MTI.

REXHEP BLLACA: Kryetar, fola pak më herët, por nëse më lejoni, do t'i jap disa sqarime që u ngritën këtu?

KRYETARI: Mundeni sqarime, por ne sot jemi për t'i marrë idetë, e pastaj ato i diskutojmë. Mirëpo, nëse e dini që ka nevojë, t'i jepni, pse jo. Urdhëroni!

REXHEP BLLACA: Këtu u cek, sa i përket kritereve të larta... Ne duhet të kemi parasysh se kemi shkuar me kritere pak më të larta, për arsye se po flasim për investitorë strategjikë, kur do të tejkalohej të gjitha procedurat e prokurimit dhe Qeveria do të ketë të drejtën që të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me investitorin strategjik.

Ndërsa, sa i përket uljes së kritereve, ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë, çdo sugjerim që e përmirëson ambientin e biznesit e përkrahim, mirëpo pse kemi vendosur kritere pak më të larta është se për arsye që kemi të bëjmë vetëm me investitorë strategjikë dhe procedurat e tenderimit dhe procedurat e prokurimit do të tejkalohej dhe këtu u përmendën lejet dhe licencat, të gjithë investitorët strategjikë do të kenë prioritet sa i përket marrjes së lejeve dhe licencave. Është aty në ligj edhe një nen që thotë – maksimum, çdo organ qeveritar për të lëshuar një leje dhe një licencë duhet t'i kenë 30 ditë, dhe brenda 30 ditëve nëse nuk e lëshon lejen dhe licencën atëherë ai organ është përgjegjës, duke i përfshirë të gjitha llojet e përgjegjësisë sa i përket marrjes së lejeve dhe licencave.

Këtu po ashtu u përmend edhe afati i vlefshmërisë së këtij ligji dhe unë në fillim e potencova por edhe ish kryesuesi e potencoi që ky projektligj ka pak probleme sa i përket direktivave evropiane dhe jemi në procesin e stabilizim-asociimit dhe mu për këtë ne kemi vendosur që vlefshmëria e këtij projektligji të jetë deri në fund të vitit 2018, mirëpo megjithatë kjo mund të diskutohet dhe zgjatet ky afat. Faleminderit!

KRYETARI: A ka ndokush edhe ndonjë intervenim? Urdhëroni! Zoti Selimaj, edhe një herë.

BRAHIM SELIMAJ: E kam një intervenim të vogël!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Neni 7, procedurat dhe vlerësimi për zgjedhje dhe realizimi i projektit strategjik.

Të gjithë këta që janë të përfshirë, Ministria e Tregtisë, e Ministria e Financave, ku është baza, që duhet të kalojë nëpërmjet bazës, përmjet bazës që unë them – ekonomia? Dhe le të jepet vlerësimi paraprakisht, para se të vijnë këtu, është dashur vlerësimi, përmes shoqatave, përmes odave, dhe ta ketë një bazë kjo pak më të fuqishme. Faleminderit!

KRYETARI: Me nderë qofshi! Unë mendoj që patëm një diskutim mjaft interesant dhe është e natyrshme që të kemi një diskutim të tillë për arsye se po flasim për investimet. Investimet faktikisht janë pika më kritike e zhvillimit ekonomik në Kosovë sepse rritja ekonomike e pamjaftueshme në Kosovë është pasojë e investimeve të vogla. Pra, kemi do të thotë investime diku rreth 25% të GDP-së dhe në nivelin e zhvillimit në të cilin jemi duhet të shkojë deri në 32% për me qenë rritja ekonomike që na duhet 7% , e tjera, e tjera. Mos të shkojmë më tuje.

Prandaj, ne e kemi mirëpritur si komision këtë ligj nga Ministria dhe e kemi dërguar në Parlament, është bërë leximi i parë tash jemi në konsultime dhe në amendamente që t'i përmirësojmë dhe evitojmë dilemat. Natyrisht se janë disa dilema.

Gjithashtu, mendoj se duhet të kemi parasysh se ky ligj është për investimet strategjike, nuk është për të gjitha investimet. E kur diskutojmë për këtë ligj, do të thotë ne duhet të shohim gjendjen në të cilën gjendet Kosova, në një aktivitet të pamjaftueshëm investues, ka nevojë që të tërheq disa investitorë që kanë emër, që kanë parime të njohura etike dhe që mund të krijojnë një diferencë në zhvillim.

Prandaj, jo secili investitor dhe jo secili investim duhet të hyrë në këtë ligj. Esenca e këtij ligji është pikërisht edhe për nga vëllimi i investimeve por edhe për nga profili i investitorit që duam ta arrijmë.

Dhe tash, meqenëse kemi një profil që është i mirënjohur dhe që ka referenca në botë, që ka bërë investime, që e ka emrin e pastër dhe etikën e lartë, ndoshta për një periudhë të caktuar ne mund të bëjmë një shmangie të procedurave të rregullta por duke ndërtuar transparencë dhe llogaridhënie, duke e siguruar këtë në mënyrën më precize.

E tash ne në këtë drejtim sigurisht se do të diskutojmë edhe me Bashkimin Evropian dhe të gjejmë masën e nevojshme për një periudhë, për një stad të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës dhe duhet ndoshta edhe ligjet specifike, jo ligjet si janë në vendet që janë veç në zhvillim, një stad të lartë të zhvillimit, e ne duhet të rrisim investimet. Mirëpo, unë mendoj se nuk mund të fusim çdo investim dhe çdo investitor brenda këtij ligji, sepse atëherë kemi të drejtë, meqë këtu ne po i shmangim procedurat e prokurimit. Dhe duhet ditur se në cilin rast mund t'i shmangim, në cilin rast... Duhet të jemi shumë precizë, jo në secilin rast. Pra, në cilin rast dhe si këmbim ndaj shmangies së procedurave të prokurimit ne duhet të sigurojmë transparencën maksimale, e në anën tjetër edhe llogaridhënien.

Do të thotë të shohim, se në këtë ligj ka disa indikacione. Ne do të punojmë bashkë me juve, me të gjithë, ta forcojmë këtë situatë, edhe në koordinim me Bashkësinë Evropiane. Asgjë nuk do të bëhet që do ta pengojë ecjen e Kosovës në liberalizim të vizave dhe në stabilizim-asociim.

Kjo është e tëra dhe besoj se patëm shumë diskutime të mira këtu. Do t'i marrim në konsiderim dhe ju falënderoj shumë për diskutim. Do të flet edhe kolegu Qela, ka një intervenim. Pra, ju falënderoj për të gjitha sugjerimet që i keni dhënë.

Ne e kemi të regjistruar këtë debat dhe do t'ju kontaktojmë edhe më tutje që ta bëjmë një ligj, por mos të zgjasim shumë, me muaj, por të shohim me rend dhe jo duke ngutur e bërë gabime, por natyrisht të punojmë në mënyrën sa më efektive që disa probleme dhe disa dilema që i kemi në ligjin, t'i zgjidhim në mënyrën më të mirë por jo duke e zgjatur ligjin apo duke thënë se s'e kemi nevojë.

Ne kemi nevojë shumë të biem investitorë me emër në Kosovë dhe kjo është jo që i duhet Kosovës. Kemi nevojë jashtëzakonisht të madhe. Dhe ndoshta investitorët që kanë emër pikërisht nuk hyjnë në procedura të prokurimit sepse e dinë çfarë probleme kemi në procedura të prokurimit. E unë mund t'i përmendim shembujt, ku kemi pasur investitorë në fillim me këtë ligj të prokurimit që po donë me iu kundërvuar këtij ligji, unë jam për prokurim, jam për të gjitha, por ne e dimë se çfarë prokurimi kemi dhe çfarë investitorësh kemi pasur deri tash. Urdhëroni, zoti Qela!

RAIF QELA: Të nderuar të pranishëm!

Në mënyrë që edhe ju të jeni pjesë – bashkautorë të këtij ligji, ashtu siç kërkoi edhe zoti Kryeziu, ju lus që secili prej jush çdo vërejtje që keni, jo vetëm këtë këtu që e keni thënë ta dërgoni me shkrim në e-mailin zyrtar të Komisionit për zhvillim ekonomik, dhe Komisioni këtë ta ketë parasysh dhe secilën prej vërejtjeve tuaja do ta shqyrtojë në mënyrë që, nëse i sheh të nevojshme, i fut si amendamente në ligj.

Ky projektligj tash është në fazën e dëgjimit publik dhe ky dëgjim publik është bërë pikërisht që të dëgjohen edhe vërejtjet tuaja, në mënyrë që ato të futen pastaj në ligj. Tanimë punën e ka vetëm Komisioni për zhvillim ekonomik dhe Kuvendi i Kosovës i cili në leximin e dytë do t'i përfundojë të gjitha amendamentet e miratuara prej nesh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sasha Milosavljeviq e ka fjalën, zëvendëskryetar i Komisionit! Urdhëroni!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Ovde je dosta toga izneto i ono što smo mi kao Poslanička grupa primetili da u Zakonu treba da se menja amandmanima, smatram da je vrlo važno da se kaže da, s obzirom da je članovima 18, 22, i 23 Nacrta ovog zakona predviđeno korišćenje i dostupnost javne, socijalne ili društvene imovine, ... strateski... treba na 40 godina. Čuli smo ovde i predlog da bude na 99.

Posebno bi trebalo obratiti pažnju na nerešeno pitanje restitucije imovine nacionalizovane od fizičkih i pravnih lica posle drugog svetskog rata. Znači, najveći deo javne, socijalne ili društvene imovine potiče od privatne imovine koju je oduzeo komunistički režim.

Mi smo se svi ovde složili da statistički investitori koji žele da ulažu u budućnosti na Kosovu će sigurno tražiti sigurnost u onom biznisu u kojem žele da ulože i bave se na Kosovu.

Zato smatramo da mi kao Poslanička grupa da je ovo pitanje veoma diskutabilno i da treba prvo da se reši da bi privukli, kao što je rekao predsednik, strateške investitore koji u budućnosti žele da ulažu na Kosovu.

I smatramo da u Komisiji, koja je za procenu izbora i sprovođenja strateskih projekata bez obzira što imamo jednog člana, tojest jednog ministra iz ove ministarske grupe, ministra od nevećinske zajednice, smatramo da tu treba da bude obavezno i ministar za zajednice i povratak jer se ovo tiče i ovaj zakon je bitan za sve zajednice koje žive na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit Sasha! Përndryshe, këtu është me rëndësi që komunat, nëse diçka ndërlidhen me ndonjë komunë të caktuar, gjithmonë do të kenë përfaqësuesin e komunës në komision. Kjo është, sa e di unë, a?

(Ndërhyrje)

Po! Mirë! A e do ndokush tjetër fjalën? Atëherë, ju falënderoj dhe ne do ta marrim Transkriptin dhe shohim kontributet me shkrim, e nëse i keni, edhe formulimet që i tha edhe kolegu Raifi, na i dërgoni.

Ne do të shkojmë tash dalëngadalë, do t'i mbledhim edhe amendamentet e deputetëve e të komisioneve tjera, nëse i kanë, dhe do të fillojmë hartimin e amendamenteve nga ana e komisionit tonë.

Lidhur me këtë ne na duhen edhe disa konsultime, të caktuara sigurisht edhe me Komisionin Evropian, të shohim e gjejmë zgjidhjen për këtë brengën e tyre. Ju faleminderit!

E transkriptoi:

Njësia për transkriptim.

